

VENDIM
Nr. 583, datë 1.7.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR APARATIN
E KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aparatit të Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për bashkëfinancimin e efekteve financiare të vitit 2015 të planit të veprimit të projektit “STAR”, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur nga ministri i Shtetit për Çështjet Vendore dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2015.

3. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama